



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 134

Tiranë – E mërkurë, 12 tetor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 68/2022, datë 22.9.2022	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi Organizatën Ndërkombëtare për Ndihmat Detare në Lundrim..... 16745
Dekret i Presidentit nr. 13857, datë 6.10.2022	Për shpallje ligji..... 16752
Vendim i Kuvendit nr. 78/2022, datë 3.10.2022	Për zgjedhjen e zonjës Arta Mandro, anëtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar..... 16752
Vendim i Kuvendit nr. 79/2022, datë 6.10.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar 16752
Vendim i Kuvendit nr. 80/2022, datë 6.10.2022	Për ngritjen e Nënkomisionit për Mjedisin dhe Bujqësinë në Përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin..... 16753
Dekret i Presidentit nr. 13858, datë 6.10.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 16753
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 650, datë 10.10.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar..... 16754
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.10.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i segmentit rrugor ‘Shkodër (mbikalimi i trenit) – MES”..... 16754

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 10.10.2022	Për miratimin e amendimit të kontratës së miratuar me vendimin nr. 350, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku 4, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe <i>Shell Albania Block 4 B.V.</i>	16755
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 654, datë 10.10.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 605, datë 14.9.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për indeksimin e pensioneve”.....	16760
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 655, datë 10.10.2022	Për disa shtesa në vendimin nr. 149, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e të aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”.....	16760
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 656, datë 10.10.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 314, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”.....	16761
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 657, datë 10.10.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 502, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore ‘Regjistri elektronik i ekspertëve’”.....	16761
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 10.10.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 879, datë 12.8.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar, gjimnazi ‘Linz’, në qytetin e Tiranës”.....	16764
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 10.10.2022	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar.....	16764
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbojtjen e të Dhënave Personale nr. 189, datë 4.10.2022	Për një shtesë dhe disa ndryshime në udhëzimin nr. 463, datë 10.12.2020, “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”.....	16765
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 193, datë 6.10.2022	Për delegimin e kompetencave.....	16767
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 195, datë 10.10.2022	Për delegimin e kompetencave.....	16767
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 298, datë 4.10.2022	Për ushtrimin e detyrave të drejtorit të Prokurimeve dhe Partneriteteve në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.....	16767
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 442, datë 6.10.2022	Për disa shtesa në urdhrin nr. 365, datë 10.8.2022, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Hungaria, Letonia, Ukraina, Rumania, Italia, Gjermania, Lituania, Moldavia, Sllovakia, Serbia, Estonia, Bullgaria, Polonia dhe Maqedonia e Veriut”, të ndryshuar.....	16768

Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 570, datë 30.9.2022	Për delegimin e kompetencave.....	16768
Urdhër i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 602, datë 6.10.2022	Për delegimin e kompetencave.....	16769
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 41, datë 5.10.2022	Për shfuqizimin e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 49, datë 5.8.2020, “Për miratimin e mbylljes së fazuar të aktivitetit të ndërmjetësimit të investimit të personave fizikë në bono thesari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë”, dhe për miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 33, datë 6.7.2022, “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren, ‘Për funksionimin e Sistemit Qendror të Regjistrimit dhe Shlyerjes së Titujve (AFISAR)’”.....	16769
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 418, datë 29.9.2022	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 122, datë 20.10.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujës-jellës-Kanalizime Kukës”.....	16770



LIGJ
Nr. 68/2022

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË KONVENTËN MBI
ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE
PËR NDIHMAT DETARE NË LUNDRIM

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën mbi Organizatën Ndërkombëtare për Ndihmat Detare në Lundrim, sipas tekstit të konventës bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.9.2022.

Shpallur me dekretin nr.13857, datë 6.10.2022,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

KONVENTA MBI ORGANIZATËN
NDËRKOMBËTARE PËR NDIHMAT
DETARE NË LUNDRIM

Preambulë

Shtetet Palë të kësaj Konvente:

Duke pasur parasysh se Shoqata Ndërkombëtare e Autoriteteve të Fareve u krijua më 1 korrik 1957 dhe u riemërtua Shoqata Ndërkombëtare e Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve në vitin 1998;

Duke njohur rolin e Shoqatës Ndërkombëtare të Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve në përmirësimin dhe harmonizimin e vazhdueshëm të Ndhimave Detare në Lundrim për

lëvizjen e sigurt, ekonomike dhe efikase të anijeve në dobi të komunitetit detar dhe mbrojtjes së mjedisit;

Duke marrë në konsideratë dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin për Detin, 1982 dhe të Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, të ndryshuar; dhe

Duke marrë në konsideratë më tej se zhvillimi, përmirësimi dhe harmonizimi i Ndhimave Detare në Lundrim në dobi të komunitetit detar dhe mbrojtjes së mjedisit koordinohet më mirë nga organizatat ndërkombëtare,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Themelimi

1. Organizata Ndërkombëtare për Ndihmat Detare në Lundrim (në vijim e referuar si “Organizata”) është themeluar, sipas së drejtës ndërkombëtare si organizatë ndërqeveritare.

2. Organizata do të ketë natyrë konsultative dhe teknike.

3. Organizata do të ketë selinë e saj në Francë, përveç nëse vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

4. Funksionimi i Organizatës do të përcaktohet hollësisht në Rregulloret e Përgjithshme, të cilat u nënshtrohen dispozitave të kësaj Konvente, por nuk janë pjesë përbërëse e saj. Në rast të ndonjë mospërputhjeje midis kësaj Konvente dhe Rregullores së Përgjithshme ose çdo dokumenti tjetër bazë, që mbulon qeverisjen e Organizatës, kjo Konventë do të ketë përparësi.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. “**Ndihma Detare për Lundrim**” do të thotë një pajisje, sistem ose shërbim, jashtë një anijeje, i projektuar dhe i synuar për të rritur lundrimin e sigurt dhe efikas të anijeve individuale dhe trafikut të anijeve. Për qëllimin e Organizatës, ky përkufizim përfshin Shërbimet e Trafikut të Anijeve.

2. “**Shtet Anëtar**” nënkupton një shtet që ka dhënë miratimin për të zbatuar këtë Konventë dhe për të cilin kjo Konventë është në fuqi.



3. **“Anëtar i Asociuar”** nënkupton një territor ose grup terriroresh për të cilët një Shtet Anëtar ka përgjegjësi për marrëdhëniet e tij ndërkombëtare dhe për të cilat ka kërkuar anëtarësim që është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme dhe anëtarë kombëtarë të Shoqatës Ndërkombëtare të Ndihmave Detare në Lundrim dhe Autoritetet e Fareve nga Shtetet që nuk janë Shtete Anëtare, në përputhje me paragrafin 5 të shtojcës.

4. **“Anëtar Filial”** nënkupton një prodhues ose shpërndarës të pajisjeve të lundrimit për shitje, ose një organizatë që siguron Ndihma Detare për shërbimet e lundrimit ose këshilla teknike, sipas kontratës dhe çdo organizatë ose agjenci tjetër shkencore e përfshirë në Ndihamat Detare për Lundrim, e cila ka aplikuar për anëtarësim dhe që është miratuar nga Këshilli.

Neni 3

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i Organizatës është të sjellë së bashku qeveritë dhe organizatat e interesuara për rregullimin, ofrimin, mirëmbajtjen ose funksionimin e Ndihmave Detare për Lundrim, në mënyrë që të zhvillojnë më tej, objektivat e:

a) Nxitjes së lëvizjes së sigurt dhe efikase të anijeve nëpërmjet përmirësimit dhe harmonizimit të Ndihmave Detare në Lundrim në mbarë botën, në dobi të komunitetit detar dhe mbrojtjes së mjedisit detar;

b) Promovimit të aksesit në bashkëpunimin teknik dhe ngritjes së kapaciteteve për të gjitha çështjet që lidhen me zhvillimin dhe transferimin e ekspertizës, shkencës dhe teknologjisë në lidhje me Ndihamat Detare në Lundrim;

c) Inkurajimit dhe lehtësimit të miratimit të përgjithshëm të standardeve më të larta të zbatueshme në çështjet që lidhen me Ndihamat Detare në Lundrim; dhe

d) Parashikimit të shkëmbimit të informacionit mbi çështjet nën shqyrtim nga Organizata.

Neni 4

Funksionet

Për të arritur qëllimin dhe objektivat e përcaktuar në nenin 3, funksionet e Organizatës do të jenë:

a) Të zhvillojë dhe të komunikojë standardet, rekomandimet, udhëzimet, manualët dhe dokumentet e tjera të duhura;

b) Të marrë në konsideratë dhe të bëjë rekomandime për standardet, rekomandimet, udhëzimet, manualët dhe dokumentet e tjera të përshtatshme, që mund t'i dërgohen nga Shtetet Anëtare, Anëtarët e Asociuar dhe Anëtarët Filialë, nga çdo organ ose agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara ose nga çdo organizatë tjetër ndërqeveritare;

c) Të sigurojë mekanizma për konsultimin dhe shkëmbimin e informacionit që mbulon, ndër të tjera, zhvillimet e fundit dhe aktivitetet e Shteteve Anëtare, Anëtarëve të Asociuar dhe Anëtarëve Filialë,

d) Të zhvillojë bashkëpunimin ndërkombëtar, duke promovuar marrëdhënie të ngushta pune dhe asistencë ndërmjet Shteteve Anëtare, Anëtarëve të Asociuar dhe Anëtarëve Filialë,

e) Për të lehtësuar ndihmën, qoftë teknike, organizative apo trajnuese, për qeveritë, shërbimet dhe organizatat e tjera që kërkojnë ndihmë me Ndihamat Detare në Lundrim;

f) Të organizojë konferenca, simpoziume, seminare, takime pune dhe evente të tjera; dhe

g) Të lidhet dhe të bashkëpunojë me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe të tjera, duke ofruar këshilla të specializuara, në rastet kur është e nevojshme.

Neni 5

Anëtarësimi

1. Organizata do të përbëhet nga Shtetet Anëtare, Anëtarët e Asociuar dhe Anëtarët Filialë;

2. Çdo shtet anëtar që ka përgjegjësi për marrëdhëniet ndërkombëtare të një territori ose grupi terriroresh, mund të kërkojë anëtarësimin e asociuar për këtë territor ose grup terriroresh, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm.

3. Këshilli mund të kërkojë ose një Shtet Anëtar mund të kërkojë që aspektet e një aplikimi për anëtarësim Filial të rishikohen nga Shteti Anëtar ose Shtetet Anëtare, ku aplikuesi kryen aktivitetet e tij ose ka vendin e tij kryesor të biznesit ose zyrën e regjistruar. Këshilli do të marrë parasysh pikëpamjet e Shteteve Anëtare kërkuuese dhe rishikuese, kur vendos për anëtarësimin Filial.



Neni 6 Organet

1. Organizata do të ketë si organe të saj:
 - a) Asamblenë e Përgjithshme;
 - b) Këshillin;
 - c) Komitetet dhe organet ndihmëse të nevojshme për të mbështetur aktivitetet e Organizatës; dhe
 - d) Sekretariatit.
2. Do të ketë një President dhe një Zëvendëspresident të Organizatës. Presidenti ose në rast të mungesës së Presidentit, Zëvendëspresidenti kryeson Asamblenë e Përgjithshme dhe Këshillin.
3. Rregulloret e Përgjithshme dhe Rregulloret Financiare do të përmbajnë detajet e Rregullave të Procedurës, që do të zbatohen për secilin organ dhe qeverisin menaxhimin e përditshëm të Organizatës.

Neni 7 Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi kryesor vendimmarrës i Organizatës dhe do të ketë të gjitha kompetencat e Organizatës, përveç nëse parashikohet ndryshe nga kjo Konventë.
2. Asambleja e Përgjithshme do të përbëhet vetëm nga Shtetet Anëtare. Pjesëmarrja do të jetë gjithashtu e hapur për Anëtarët e Asociuar dhe Anëtarët Filialë.
3. Çdo Shtet Anëtar do të caktojë një nga përfaqësuesit e tij si përfaqësuesin e tij kryesor në Asamblenë e Përgjithshme.
4. Seancat e rregullta të Asamblesë së Përgjithshme zhvillohen një herë në tre vjet.
5. Seancat e jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme do të thirren sa herë që një e treta e Shteteve Anëtare i njoftojnë Sekretarit të Përgjithshëm se dëshirojnë që të mbledhet një seancë, ose në çdo kohë nëse çmohet e nevojshme nga Këshilli, pas një njoftimi prej nëntëdhjetë ditësh.
6. Shumica e Shteteve Anëtare do të përbëjnë kuorumin për seancat e Asamblesë së Përgjithshme.
7. Asambleja e Përgjithshme:
 - a) Zgjedh Presidentin dhe Zëvendëspresidentin nga shtetet anëtare, në përputhje me Rregulloret e Përgjithshme;

- b) Vendosi politikën e përgjithshme dhe vizionin strategjik të Organizatës;
- c) Rishikon dhe miraton Rregulloret e Përgjithshme dhe Rregulloret Financiare të Organizatës;
- d) Zgjedh Këshillin nga Shtetet Anëtare të ndryshme nga Shtetet Anëtare që kanë Presidencën ose Zëvendës Presidencën në përputhje me nenin 8;
- e) Zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm nga shtetasit e Shteteve Anëtare, në përputhje me Rregulloret e Përgjithshme;
- f) Themelon dhe përfundon Komitetet dhe organet ndihmëse dhe shqyrton e miraton Afatet e Referencave të tyre;
- g) Rishikon dhe miraton masat financiare të Organizatës, përfshirë buxhetin e përgjithshëm për tri vitet e ardhshme dhe shkallën e kontributeve për Shtetet Anëtare dhe tarifën për Anëtarët e Asociuar dhe Anëtarët Filialë;
- h) Shqyrton raportet dhe propozimet e paraqitura nga çdo Shtet Anëtar, Këshilli ose Sekretari i Përgjithshëm;
- i) Miraton standardet;
- j) Vendosi për anëtarësimin e Asociuar;
- k) Drejton anëtarësimin Filial me kërkesë të një ose më shumë Shteteve Anëtare;
- l) U jep rekomandime Shteteve Anëtare, Anëtarëve të Asociuar dhe Anëtarëve Filialë për çështje brenda qëllimit dhe objektivave të Organizatës;
- m) Miraton marrëveshje me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare; dhe
- n) Vendosi për çdo çështje tjetër brenda qëllimit dhe objektivave të Organizatës.

Neni 8 Këshilli

1. Këshilli është organi ekzekutiv i Organizatës dhe është përgjegjës për drejtimin e aktiviteteve të Organizatës.
2. Këshilli përbëhet nga Presidenti dhe Zëvendëspresidenti dhe njëzet e tre Shtete të tjera Anëtare.
3. Anëtarët e Këshillit zgjidhen me votim në çdo seancë të rregullt të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme. Anëtarët e Këshillit, në parim, duhet



të zgjidhen nga pjesë të ndryshme të botës, me qëllim arritjen e një përfaqësimi mbarëbotëror.

4. Në Këshill, Shtetet Anëtare preferohet të përfaqësohen nga një delegat nga një autoritet kombëtar përgjegjës për rregullimin, sigurimin, mirëmbajtjen ose funksionimin e Ndhimave Detare për Lundrimin e atij Shteti Anëtar.

5. Shtatëmbëdhjetë anëtarë të Këshillit, të paktën njëri prej të cilëve duhet të jetë Presidenti ose Zëvendëspresidenti, do të përbëjnë kuorumin për seancat e Këshillit.

6. Këshilli mbledhet të paktën një herë në vit.

7. Çdo shtet anëtar që nuk përfaqësohet në Këshill mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit, por nuk do të ketë të drejtë vote.

8. Këshilli:

a) Ushtron ato përgjegjësi që mund t'i delegohen Asamblesë së Përgjithshme;

b) Koordinon aktivitetet e Organizatës brenda kuadrit të politikës së përgjithshme, vizionit strategjik dhe buxhetit të përgjithshëm të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme;

c) Shqyrton dhe miraton pasqyrat financiare, përfshirë buxhetin vjetor;

d) Vendos për anëtarësimin Filial;

e) Thërret Asamblesë së Përgjithshme;

f) I raporton Asamblesë së Përgjithshme mbi punën e Organizatës;

g) Rishikon dokumentet e paraqitura në përputhje me Rregulloret e Përgjithshme;

h) I referon Asamblesë së Përgjithshme të gjitha çështjet, që kërkojnë vendim nga Asambleja e Përgjithshme;

i) Miraton rekomandimet, udhëzimet, manualët dhe dokumentet e tjera të përshtatshme;

j) Miraton parashtrimet për organizatat e tjera;

k) Emëron Kryetarë dhe Nënkryetarë të Komiteteve dhe organeve ndihmëse dhe shqyrton dhe miraton programet e tyre të punës;

l) Vendos vendin dhe vitin e konferencave dhe simpoziumeve të Organizatës, siç përshkruhet në Rregulloret e Përgjithshme; dhe

m) Miraton Rregullat e Personelit.

9. Anëtarët e Këshillit, pasi të kenë informuar Presidentin dhe Sekretarin e Përgjithshëm, mund të ftojnë Anëtarët Filialë, që të marrin pjesë si këshilltarë teknikë në mbledhjet e Këshillit për të dhënë këshilla dhe mbështetje për çështje operacionale dhe teknike.

Neni 9

Komitetet dhe organet asistuese

1. Komitetet dhe organet asistuese do të mbështesin qëllimin dhe objektivat e Organizatës.

2. Komitetet:

a) Përgatisin dhe rishikojnë standardet, rekomandimet, udhëzimet, manualët dhe dokumentet e tjera të përshtatshme të identifikuara në programet e punës;

b) Monitorojnë zhvillimet në fushën e Ndhimave Detare në Lundrim;

c) Lehtësojnë ndarjen e ekspertizës dhe përvojës midis Shteteve Anëtare, Anëtarëve të Asociuar dhe Anëtarëve Filialë; dhe

d) Kryejnë çdo detyrë tjetër të vendosur nga Këshilli.

Neni 10

Sekretariati

1. Sekretariati i Përhershëm i Organizatës do të përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe personeli, që mund të kërkohej për punën e Organizatës, brenda kuadrit buxhetor të miratuar.

2. Mandati i Sekretarit të Përgjithshëm do të jetë tre vjet. Sekretari i Përgjithshëm mund të rizgjidhet për deri në dy mandate të njëpasnjëshme trevjeçare secila.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të Organizatës, në bazë të çdo udhëzimi të lëshuar nga Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli.

4. Sekretari i Përgjithshëm do të jetë përgjegjës për lidhjen e marrëveshjeve me Shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me nenin 7.7(m).

5. Personeli i Sekretariatit emërohet në përputhje me Rregullat e Personelit nga Sekretari i Përgjithshëm me kushte dhe për të kryer detyra të caktuara nga Sekretari i Përgjithshëm.

6. Sekretariati do të:

a) mbajë të gjitha regjistrat që mund të jenë të nevojshëm për kryerjen efikase të punës së Organizatës dhe do të përgatisë, mbledhë dhe qarkullojë çdo dokumentacion që mund të kërkohej;



b) administrojë financat e Organizatës nën drejtimin e Këshillit, në përputhje me Rregulloret e Përgjithshme;

c) përgatisë masat financiare dhe pasqyrat financiare;

d) mbajë të informuar Shtetet Anëtare, Anëtarët e Asociuar dhe Anëtarët Filialë dhe organizatat e tjera, në lidhje me aktivitetet e Organizatës;

e) organizojë dhe mbështesë takimet e Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit, Komiteteve dhe organeve ndihmëse;

f) organizojë dhe mbështesë konferencat dhe simpoziumet e miratuara nga Këshilli;

g) organizojë dhe mbështesë seminarët, takimet e punës dhe evente të tjera; dhe

h) kryejë funksione të tjera të caktuara nga kjo Konventë, Rregulloret e Përgjithshme, Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli.

7. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre, Sekretari i Përgjithshëm dhe personeli nuk do të kërkojnë ose marrin udhëzime nga asnjë qeveri ose nga asnjë burim tjetër jashtë Organizatës. Ata do të përmbahen nga çdo veprim që mund të reflektojë në pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë përgjegjës vetëm ndaj Organizatës. Secili shtet anëtar nga ana e tij merr përsipër të respektojë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësisë së Sekretarit të Përgjithshëm dhe personelit dhe të mos kërkojë t'i ndikojë në kryerjen e përgjegjësisë së tyre.

Neni 11 Votimi

1. Të gjitha përpjekjet do të bëhen që Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli të miratojnë vendime me konsensus ndërmjet Shteteve Anëtare.

2. Aty ku vendimet e Asamblesë ose Këshillit të Përgjithshëm nuk mund të miratohen me konsensus, atëherë do të miratohen nga shumica e dy të tretave të Shteteve Anëtare të pranishme përmes një votimi të fshehtë.

3. Vetëm Shtetet Anëtare kanë të drejtën e votës. Çdo Shtet Anëtar ka një votë, përveç siç përcaktohet në nenin 13.4.

Neni 12 Gjuhët

Gjuhët zyrtare të Organizatës do të jenë gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle.

Neni 13 Financat

1. Shpenzimet për funksionimin e Organizatës do të mbulohen nga burimet financiare siguruar nga:

a) Kontributet e Shteteve Anëtare;

b) Tarifat e Anëtarëve të Asociuar dhe Anëtarëve Filialë; dhe

c) Donacionet, dhurimet, grantet, dhuratat dhe burime të tjera të miratuara nga Këshilli me rekomandimin e Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Çdo Shtet Anëtar do të paguajë një kontribut dhe çdo Anëtar i Asociuar dhe Anëtar Filial do t'i paguajë një tarifë Organizatës në baza vjetore në shumën e përcaktuar, në përputhje me nenin 7.7(g). Kontributi do të vendoset me të njëjtën normë për secilin Shtet Anëtar.

3. Kontributet e Shteteve Anëtare dhe Anëtarët e Asociuar dhe Tarifat e Anëtarëve Filialë do të paguhën në përputhje me Rregulloret Financiare.

4. Çdo Shteti Anëtar, i cili ka dy vjet vonesë në dhënien e kontributeve, pas njoftimit me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm, do t'i mohohet e drejta e votës dhe e drejta për t'u zgjedhur në Këshill, derisa të jenë paguar kontributet e papaguara, në përputhje me Rregulloret Financiare, përveç nëse Asambleja e Përgjithshme heq dorë nga kjo dispozitë.

5. Pas miratimit të pasqyrave financiare të audituara të Organizatës nga Këshilli, këto pasqyra do t'u shpërndahen të gjitha Shteteve Anëtare, Anëtarëve të Asociuar dhe Anëtarëve Filialë në Raportin Vjetor.

Neni 14 Personaliteti Juridik, Privilegjet dhe Imunitetet

1. Organizata ka personalitet juridik ndërkombëtar dhe ka aftësinë, për:

a) të kontraktuar dhe lidh marrëveshje me qeveritë, organizatat dhe organet e tjera;

b) të fituar dhe disponuar prona të paluajtshme dhe të luajtshme; dhe

c) procedura ligjore të Institutit.

2. Në territorin e secilit prej Shteteve Anëtare të saj, Organizata do të gëzojë, në masën e parashikuar në marrëveshje me Shtetin Anëtar në fjalë, privilegjet dhe imunitetet që mund të jenë të



nevojshme për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e qëllimit dhe objektivat e saj.

3. Asnjë Shtet Anëtar, Anëtar i Asociuar ose Anëtar Filial nuk do të jetë përgjegjës, për shkak të statusit të tij ose pjesëmarrjes në Organizatë, për veprimet, mosveprimet ose detyrimet e Organizatës.

Neni 15 Ndryshimet

1. Çdo Shtet Anëtar mund t'i propozojë Sekretarit të Përgjithshëm një ndryshim me shkrim lidhur me këtë Konventë.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të qarkullojë ndryshimin e propozuar në gjuhët zyrtare në të gjitha Shtetet Anëtare, të paktën gjashtë muaj përpara shqyrtimit nga Asambleja e Përgjithshme.

3. Ndryshimi i propozuar do të miratohet me votë në Asamblenë e Përgjithshme.

4. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 do t'i dërgohet depozituesit nga Sekretari i Përgjithshëm. Depozituesi do të njoftojë të gjitha Shtetet Anëtare për miratimin e ndryshimit.

5. Ndryshimi do të hyjë në fuqi për të gjitha Shtetet Anëtare gjashtë muaj pasi njoftimet me shkrim të pranimit nga dy të tretat e Shteteve Anëtare janë marrë nga Depozituesi, përveç një Shteti Anëtar që e ka njoftuar Depozituesin, para hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi, se ndryshimi do të hyjë në fuqi për atë Shtet Anëtar, vetëm pas një njoftimi të mëvonshëm të pranimit të tij.

6. Pavarësisht nga paragrafi 5, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë me konsensus se ndryshimi do të hyjë në fuqi për të gjitha Shtetet Anëtare gjashtë muaj pasi njoftimet me shkrim të pranimit nga dy të tretat e Shteteve Anëtare janë marrë nga Depozituesi. Nëse brenda kësaj periudhe prej gjashtë muajsh një Shtet Anëtar jep njoftimin për tërheqjen nga Organizata, për shkak të një ndryshimi, tërheqja, pavarësisht nga neni 21, do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ky ndryshim hyn në fuqi.

7. Depozituesi do të informojë Shtetet Anëtare dhe Sekretarin e Përgjithshëm për hyrjen në fuqi të ndryshimit, duke specifikuar datën e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 16 Rezervat

Asnjë rezervë nuk do t'i bëhet kësaj Konvente.

Neni 17 Interpretimi dhe mosmarrëveshjet

Shtetet Anëtare do të bëjnë çdo përpjekje për të parandaluar mosmarrëveshjet në interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente dhe do të përdorin përpjekjet e tyre më të mira për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje me mjete paqësore, të cilat mund të përfshijnë konsultime dhe negociata me njëri-tjetrën dhe çdo mjet tjetër, siç është rënë dakord nga palët ndaj mosmarrëveshjes.

Neni 18 Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe anëtarësimi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga çdo shtet që është anëtar i Kombeve të Bashkuara në Paris nga data 27 janar 2021 dhe mbetet e hapur deri më 26 janar 2022.

2. Kjo Konventë u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese.

3. Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim nga çdo shtet që është anëtar i Kombeve të Bashkuara, i cili nuk e ka nënshkruar këtë Konventë që nga dita pas datës në të cilën kjo Konventë mbyllet për nënshkrim.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te Depozituesi, i cili më pas njofton të gjitha shtetet që i kanë depozituar këto instrumente te Depozituesi dhe Sekretari i tyre i Përgjithshëm.

Neni 19 Depozituesi

Republika Franceze do të shërbejë si Depozitues për këtë Konventë. Kjo Konventë do të regjistrohet nga Depozituesi sipas nenit 102, të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 20 Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të dokumentit



të tridhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për secilin shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas depozitimit të dokumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

3. Organizimet kalimtare, që do të zbatohen me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, përcaktohen në shtojcë.

Neni 21 Tërheqja

1. Çdo Shtet Anëtar mund të tërhiqet nga kjo Konventë duke i dhënë së paku dymbëdhjetë muaj njoftim me shkrim Depozituesit, i cili do të informojë menjëherë të gjitha Shtetet Anëtare dhe Sekretarin e Përgjithshëm për një njoftim të tillë.

2. Njoftimi për tërheqjen mund të depozitohet në çdo kohë pas skadimit të gjashtë muajve nga data në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi.

3. Tërheqja hyn në fuqi më 31 dhjetor të vitit pas atij në të cilin është depozituar njoftimi për tërheqje.

Neni 22 Përfundimi

1. Kjo Konventë mund të përfundojë me votë të Asamblesë së Përgjithshme pas njoftimit të paktën prej gjashtë muajsh për këtë votë.

2. Data e përfundimit do të jetë dymbëdhjetë muaj pas datës së vendimit të mësipërm dhe, në periudhën ndërhyrëse, Këshilli do të jetë përgjegjës për mbylljen e Organizatës, në përputhje me Rregulloret e Përgjithshme.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar ligjërisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Hartuar në Paris, më 27 janar 2021, në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, secili tekst është njësoj autentik, origjinali i të cilit do të depozitohet në arkivat e Depozituesit. Depozituesi do t'i transmetojë kopjet e tij të vërtetuara të gjitha qeverive nënshkruese dhe aderuese dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës.

SHTOJCA MARRËVESHJET KALIMTARE

Në Asamblenë e XII të Përgjithshme të mbajtur në A Coruña, nga 25 deri më 31 maj 2014, Shoqata Ndërkombëtare e Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve miratoi një Rezolutë që pohonte se statusi i një Organizate Ndërkombëtare do t'u shërbente më së miri objektivave të saj dhe përcaktonte se ky status duhet arritur sa më shpejt të jetë e mundur me anë të miratimit të një konvente ndërkombëtare.

Si pasojë, neni 13 i Kushtetutës së Shoqatës Ndërkombëtare të Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve u ndryshua për të lehtësuar mbylljen e shoqatës dhe kalimin e aseteve të saj tek Organizata.

Qëllimi i marrëveshjeve kalimtare është të sigurojë përpjekjet e pandërprera ndërkombëtare për të zhvilluar, përmirësuar dhe harmonizuar Ndhimat Detare në Lundrim dhe për të lehtësuar kalimin nga Shoqata Ndërkombëtare e Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve në Organizatë.

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, Presidenti, Zëvendëspresidenti dhe Këshilli i Shoqatës Ndërkombëtare të Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve do të ftohen të bëhen President, Zëvendëspresident dhe Këshill i Organizatës dhe do të veprojnë në këto pozicione derisa Asambleja e parë e Përgjithshme e thirrur, sipas kësaj Konvente ka zgjedhur Presidentin, Zëvendëspresidentin dhe Këshillin, që duhet të ndodhë brenda një periudhe jo më të gjatë se gjashtë muaj.

2. Komitetet e Shoqatës Ndërkombëtare të Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve do të funksionojnë derisa të krijohen Komitetet, sipas kësaj Konvente.

3. Derisa të krijohet Sekretariati i Organizatës, Sekretariati i Shoqatës Ndërkombëtare të Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve do të ftohet të shërbejë, si dhe të kryejë funksionet e Sekretariatit. Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Ndërkombëtare të Ndhimave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve do të shërbejë si Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës derisa Asambleja e Përgjithshme të zgjedhë Sekretarin e Përgjithshëm në përputhje me këtë Konventë.



4. Deri në momentin kur Organizata ka miratuar Rregulloret e Përgjithshme do të funksionojë, në përputhje me Rregulloret e Përgjithshme të Shoqatës Ndërkombëtare të Ndihmave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve, pasi ndryshimet e nevojshme janë kryer.

5. Të gjithë anëtarët kombëtarë të Shoqatës Ndërkombëtare të Ndihmave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve nga Shtetet, që nuk janë Shtete Anëtare, sipas kërkesës së tyre zyrtare, do të bëhen Anëtarë të Asociuar të Organizatës për një kohëzgjatje deri në dhjetë vjet nga data e hyrja në fuqi e kësaj Konvente, përveç nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të zgjasë atë periudhë.

6. Në rast se një shtet i cili ka një ish-anëtar kombëtar me anëtarësim të asociuar, në përputhje me paragrafin 5, bëhet Shtet Anëtar, anëtarësimi i asociuar përfundon në datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për atë shtet.

7. Të gjithë anëtarët e asociuar dhe industrialë të Shoqatës Ndërkombëtare të Ndihmave Detare për Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve të përditësuar me tarifat e tyre, sipas kërkesës së tyre zyrtare, do të bëhen Anëtarë Filialë të Organizatës.

8. Transferimi i të drejtave, interesave, aseteve dhe detyrimeve nga Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave Detare të Autoritetet e Lundrimit dhe Fareve në Organizatë do të kryhet sipas ligjit francez.

DEKRET

Nr. 13857, datë 6.10.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 68/2022, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën mbi Organizatën Ndërkombëtare për Ndihamat Detare në Lundrim”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 78/2022

PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ARTA MANDRO, ANËTARE TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA TRUPA E PEDAGOGËVE TË FAKULTETEVE TË DREJTËSISË DHE TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016, “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës; nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Arta Mandro zgjidhet anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Trupa e Pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datën 3.10.2022.

VENDIM

Nr. 79/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 69/2021, “PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe neneve 21 e 55, të Rregullores së Kuvendit,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën I, të vendimit nr. 69/2021, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputeti Luan Baçi nga anëtar i Komisionit për Siguri Kombëtare caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datën 6.10.2022.

VENDIM
Nr. 80/2022

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
PËR MJEDISIN DHE BUJQËSINË NË
PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR
VEPRIMTARINË PRODHUESE,
TREGTINË DHE MJEDISIN**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Nënkomisioni për Mjedisin dhe Bujqësinë në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

II. Fushat e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni janë çështjet e mjedisit dhe bujqësisë.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 9 anëtarë, si më poshtë:

- | | | |
|------------------|-----------------|------|
| 1. Agron Duka | kryetar | (AN) |
| 2. Baftjar Zeqaj | zëvendëskryetar | (PS) |

- | | | |
|---------------------|---------|------|
| 3. Ismet Beqiri | anëtar | (PS) |
| 4. Ilir Ndraxhi | anëtar | (PS) |
| 5. Fadil Nasufi | anëtar | (PS) |
| 6. Tatjana Pirro | anëtare | (PS) |
| 7. Nusret Avdulla | anëtar | (DI) |
| 8. Lefter Gështenja | anëtar | (PD) |
| 9. Ramadan Likaj | anëtar | (PD) |

Anëtarë zëvendësues:

- | | | |
|-------------------|--------|------|
| 1. Anduel Tahiraj | anëtar | (PS) |
| 2. Flamur Hoxha | anëtar | (PD) |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datën 6.10.2022.

DEKRET
Nr. 13858, datë 6.10.2022

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesën e tyre, personave të mëposhtëm:

- Behar Ahmet Muja
- Valon Ahmet Muja
- Minire Vebi Ponik (Sadikaj)
- Ardit Safet Krasniqi
- Peona Safet Krasniqi
- Arze Rahim Alishani (Parllaku)
- Fatih Gjelladin Celina
- Astrit Miftar Miftari
- Ramadan Fevzi Alishani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



VENDIM

Nr. 650, datë 10.10.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 584, DATË 8.10.2021,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË
EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN
ME ENERGJI ELEKTRIKE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “ç”, e 5, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin të zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë “Furnizuesi i tregut të lirë” sh.a. Këtyre prodhuesve me përparësi i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike të shoqëria “Furnizuesi i tregut të lirë”, në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.”

2. Në pikën 5, fjalët “... 31 dhjetor 2022.” zëvendësohen me “... 30 qershor 2023.”

3. Në pikën 6, pas fjalëve “... “OSHEE Group” sh.a., ...” shtohen “... FTL sh.a. dhe ERE...”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM

Nr. 651, datë 10.10.2022

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘SHKODËR
(MBIKALIMI I TRENIT) – MES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i segmentit rrugor ‘Shkodër (mbikalimi i trenit) – Mes”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 2 500 418 (dy milionë e pesëqind mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit është 2 500 418 (dy milionë e pesëqind mijë e katërqind e tetëmbëdhjetë) lekë dhe përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletore Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi



të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI
“RIKONSTRUKSIONI I SEGMENTIT RRUGOR ‘SHKODËR (MBIKALIMI I TRENIT) – MES”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pasurisë	Sipërfaqe totale e pronës m ²	Të dhënat e pasurisë				VLERA TOTALE (lekë)	Adresa e pronarit	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				Sip. m ²	çmimi m ²	Vlera në lek	Lloji i pasurisë			
1	Bashkëpronarët Zalli			8593	17/339	1522	287	8511	2,442,657	Truall	2,442,657	Shkodër-Golem	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Frangë	Kol	Pali	1790	112/6	250	137.2	421	57,761.20	Truall	57,761.20	Shkodër-Golem	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera paraprake								2,500,418		2,500,418		

VENDIM
Nr. 652, datë 10.10.2022

PËR MIRATIMIN E AMENDIMIT TË KONTRATËS SË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 350, DATË 12.6.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË TOKË, NË SHQIPËRI, BLOKU 4, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN) DHE SHELL ALBANIA BLOCK 4 B.V.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13, të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit

dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e amendimit të kontratës së miratuar me vendimin nr. 350, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në tokë, në Shqipëri, blloku 4, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe *Shell Albania Block 4 B.V.*, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



AMENDIM I KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI

për
KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË TOKË, NË SHQIPËRI

Bloku "4"

ndërmjet

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË TË SHQIPËRISË

(E përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore/AKBN)

dhe

Shell Albania Block 4 B.V.

Tiranë, më _____, _____, 2022



Ky Amendim i nënshkruar më _____ 2022, (në vijim referuar si “Amendimi”) nga **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë** (e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, në vijim referuar si “AKBN”), në përputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.07.1993, “Ligji për hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, përfaqësuar nga _____, si njëra Palë, dhe **Shell Albania Block 4 B.V.**, një shoqëri e organizuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Holandës (në vijim referuar si “Shell”), përfaqësuar nga Anthony Freus, si Pala tjetër, (në vijim referuar si “KONTRAKTORI”), (në vijim referuar bashkërisht si “Palët”).

HYRJE:

NDËRSA Qeveria e Shqipërisë, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore), dhe Shell Upstream Albania B.V., kanë lidhur Kontratën me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Shqipëri, në Tokë, në Bllokun 4 (në vijim referuar si “Kontrata”), e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr. 350, datë 12.06.2018, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 87, datë 14.06.2018, me datë të hyrjes në fuqi 14.06.2019;

NDËRSA Shell Upstream Albania B.V. ka transferuar tërësinë e interesit të saj mbi Kontratën të Shell Albania Block 4 B.V., sikurse dëshmohet nga Akti i Transferimit i datës 18.07.2019, me datë të hyrjes në fuqi 06.09.2019, transferim i cili i është njoftuar AKBN-së me anë të shkresës së datës 05.08.2019, me numër referencë 672;

NDËRSA Palët, në vijim të një sërë konsultimesh, duke marrë në konsideratë ndërprerjet e shkaktuara nga përhapja globale e pandemisë së Covid-19 dhe luhatshmërinë e tregut të energjisë, kanë rënë unanimisht dakord për të lejuar pezullimin e Periudhës së Parë të Kërkimit të Kontratës për një periudhë prej jo më shumë se njëzetë e katër (24) muaj nga data e njoftimit të pezullimit nga Kontraktori tek AKBN-ja, duke nënshkruar këtë Amendim të Kontratës;

NDËRSA KONTRAKTORI do t’i paguajë AKBN-së, vetëm një herë, një bonus në vlerën totale prej pesëqind mijë dollarë amerikanë (500 000 USD) për pezullimin e lartpërmendur brenda tridhjetë (30) ditëve pas datës së njoftimit të pezullimit nga KONTRAKTORI tek AKBN-ja dhe KONTRAKTORI do të investojë një milion dollarë amerikanë (1 000 000 USD) në projekte të investimeve sociale të lidhura me burimet e rinovueshme dhe tranzicionin energjetik, si rënë dakord me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

Për këtë arsye, Palët bien dakord si më poshtë:

NENI 1 RUAJTJET

1.1 Të gjitha parashikimet dhe kushtet e Kontratës që nuk preken nga Amendimi mbeten në fuqi dhe në zbatim të plotë dhe vazhdojnë të zbatohen për marrëdhënien ndërmjet Palëve të kësaj Kontrate të amenduar.



NENI 2
AMENDIMET

2.1 Pas nenit 1.92 të Kontratës, shtohet neni 1.93 me përmbajtjen e mëposhtme:

“1.93 **“Periudha e pezullimit”** është një periudhë e vetme gjatë tërësisë së kohëzgjatjes së Kontratës, që fillon nga data e njoftimit të pezullimit nga Kontraktori tek AKBN-ja, njoftim i cili duhet dhënë jo më pak se tridhjetë (30) ditë përpara përfundimit të Periudhës së Parë të Kërkimit, dhe që mbaron jo më vonë se njëzet e katër (24) muaj pas kësaj. Periudha e Pezullimit do të pezullojë Periudhën e Parë të Kërkimit të Kontratës dhe do të përjashtohet nga llogaritja e kohëzgjatjes së Periudhës së Kërkimit, në përputhje me nenin 4.1.4”.

2.2 Pas paragrafit të parë të nenit 4.1.1 të Kontratës, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Pavarësisht çdo dispozite të Kontratës, Periudha e Parë e Kërkimit pezullohet gjatë Periudhës së Pezullimit dhe do të rifillojë menjëherë pas Periudhës së Pezullimit. Gjatë Periudhës së Pezullimit, Kontraktori ka të drejtën e lirë për të zgjedhur të hyjë në Periudhën e Dytë të Kërkimit të Kontratës. Në përfundim të Periudhës së Parë të Kërkimit, në mungesë të kësaj zgjedhjeje, zbatohet neni 4.3 i Kontratës.

Garancia Bankare e depozituar nga Kontraktori për Periudhën e Parë të Kërkimit vazhdon të jetë e vlefshme edhe gjatë Periudhës së Pezullimit”.

2.3 Në fund të nenit 4.1.1 të Kontratës, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

“Gjatë periudhës së pezullimit, Kontraktori mund të zgjedhë të kryejë vetëm punime Kërkimi shtesë, duke përfshirë përpunimin e të dhënave sizmike, studime gjeologjike dhe punime të tjera të rëna dakord midis Palëve.

Punimet shtesë të Kërkimit duhet t'i paraqiten AKBN-së për miratim, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye. Të gjitha punimet e kryera janë të kualifikueshme për mbulimin e Kostove, në përputhje me nenin 7 të KNP-së”.



NË DËSHMI TË SA MË LART, ky Amendim është nënshkruar ligjërisht nga Palët përkatëse të tij në datën e përcaktuar më sipër.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Nga:

Pozicioni:

**SHELL ALBANIA BLOCK 4 B.V.**

Nga:

Pozicioni:

Anthonie Marinus FrensCountry Chairman and General Manager
Shell Companies in Albania
Shell Albania Block 4 B. V.
Dege e Shqerise se Huaj
Nipt : L91821018P
TIRANA - ALBANIA

**VENDIM****Nr. 654, datë 10.10.2022****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 605, DATË 14.9.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi parë, i pikës 11, të vendimit nr. 605, datë 14.9.2022, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përllogariten në shumën 2 060 000 000 (dy miliardë e gjashtëdhjetë milionë) lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës për paketën e rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, miratuar në buxhetin e vitit 2022, të cilat ndahen: ...”.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM**Nr. 655, datë 10.10.2022****PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 149, DATË 20.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, KARAKTERISTIKAT E PËRDORIMIT E TË AKSESIMIT, TË DHËNAT PARËSORE E DYTËSORE DHE DHËNËSIN E INFORMACIONIT TË SISTEMIT TË INTEGRUAR TË TË DHËNAVE TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i
Faqe | 16760

Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 149, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas nënndarjes “vi”, të shkronjës “b”, të pikës 11, shtohet nënndarja “vii”, me këtë përmbajtje:

“vii. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.”.

2. Pas shkronjës “e”, të pikës 12, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.”.

3. Pas shkronjës “ç”, të pikës 16, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Përveç të drejtave të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve ka të drejtë përdorimi, leximi, shkrimi dhe gjenerimi të të dhënave të hedhura nga përdoruesit e tjerë në sistem me qëllim grumbullimin e të dhënave, përpunimin e tyre statistikor, analizimin dhe përgatitjen e raporteve në kuadër të parandalimit e kriminalitetit dhe recidivizmit për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve realizon raporte periodike për Ministrinë e Drejtësisë për funksionimin dhe mbarëvajtjen e sistemit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 656, datë 10.10.2022**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 314, DATË 15.5.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, SI
DHE PËRCAKTIMIN E
RREGULLIMEVE SPECIFIKE LIDHUR
ME STRUKTURËN DHE ORGANIKËN E
QENDRËS SË PARANDALIMIT TË
KRIMEVE TË TË MITURVE
DHE TË RINJVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 133, të ligjit nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 314, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 2, pas fjalëve “... kryerjes së dënimit ...” shtohen “... ose pas lirimit me kusht ...”.

b) Në pikën 4, pas fjalës së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Qendra ushtron veprimtarinë parandaluese edhe nëpërmjet aktiviteteve dhe fushatave sensibilizuese në kuadër të rritjes së ndërgjegjësimi të komunitetit që do të mirëpresë të miturit pas përfundimit të periudhës së dënimit apo lirimit me kusht.”.

2. Në pikën 5, të kreut II, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “a”, nënndarja “vi” shfuqizohet.

b) Në shkronjën “c”, fjalët “Bashkëpunon me organet e vetëqeverisjes vendore për: ...” zëvendësohen me “Bashkëpunon dhe koordinon me institucione të tjera përgjegjëse për: ...”.

c) Pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh”, me këtë përmbajtje:

“d) Grumbullon të dhëna dhe përpunon statistika të gjeneruara nga Sistemi i Integruar i të

Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe përgatit raporte e analiza për përmirësimin e gjendjes dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit apo të rinjtë në konflikt me ligjin.

dh) Bashkëpunon me institucione të tjera vendase apo të huaja për të zhvilluar aktivitetin e saj.”.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM**Nr. 657, datë 10.10.2022**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 502, DATË 24.6.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE
SHTETËRORE ‘REGJISTRI
ELEKTRONIK I EKSPERTËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 502, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fund të titullit të vendimit, shtohen fjalët “... , i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave”.

2. Baza ligjore ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të neneve 224/a, paragrafi i dytë, e 224/d, pika 1, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit



zyrtar”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave”.

3. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i ekspertëve, i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave”. Regjistri elektronik i ekspertëve, i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhëve të shenjave përbëhet nga regjistri elektronik i ekspertëve (në vijim, “REE”) dhe nga seksioni i veçantë, regjistri elektronik i përkthyesve zyrtarë dhe interpretëve të gjuhës së shenjave (në vijim, “regjistri elektronik i përkthyesve”).”.

4. Pas pikës 13 shtohen nënpikat 13.1, 13.2, 13.3, 13.4, 13.5, 13.6, 13.7, 13.8, 13.9, 13.10, 13.11, 13.12, 13.13, 13.14, 13.15, 13.16, 13.17, 13.18, 13.19, 13.20, me këtë përmbajtje:

“13/1. Në REE ngrihet si seksion i veçantë regjistri elektronik i përkthyesve, ku grumbullohet dhe administrohet informacioni për përkthyesit dhe interpretët e gjuhës së shenjave, sipas parashikimeve të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” (në vijim, “ligji për përkthimin zyrtar”).

13/2. Regjistri elektronik i përkthyesve mbahet vetëm në format elektronik dhe ndahet në nënseksione, sipas kategorisë së informacionit që përmban. Përpunimi dhe përditësimi i informacionit në regjistrin elektronik të përkthyesve kryhen nëpërmjet një sistemi kompjuterik.

13/3. Në regjistrin elektronik të përkthyesve regjistrohen të gjithë përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave, që janë certifikuar për kryerjen e veprimtarisë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligjin për përkthimin zyrtar.

13/4. Të gjitha të dhënat, kërkesat për regjistrim dhe dokumentet shoqëruese, që duhet të jenë pjesë e regjistrit elektronik të përkthyesve, pavarësisht, nëse janë paraqitur në formë shkresore apo elektronike, regjistrohen dhe ruhen në regjistrin elektronik të përkthyesve.

13/5. Regjistri elektronik i përkthyesve plotësohet dhe përditësohet me të dhëna, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Në rast se plotësimi apo përditësimi i të dhënave në këtë regjister ka të bëjë me informacion të klasifikuar, trajtimi dhe përpunimi i tyre bëhet në përputhje me

legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

13/6. Në regjistrin elektronik të përkthyesve reflektohen si të dhëna parësore, të dhënat për:

a) numrin rendor;

b) numrin e protokollit dhe datën e regjistrimit të përkthyesit ose të interpretit në regjistrin elektronik të përkthyesve;

c) numrin/at e kontaktit;

ç) adresën zyrtare elektronike;

d) llojin e gjuhës ose gjuhëve të huaja, për të cilat është certifikuar përkthyesi;

dh) numrin e certifikatës të përkthyesit ose të interpretit;

e) datën e lëshimit të certifikatës;

ë) autoritetin lëshues të certifikatës;

f) vitet e përvojës profesionale, si dhe të dhëna për eksperiencat profesionale në fushën e përkthimit zyrtar ose interpretimit;

g) të dhënat për formën e organizimit të përkthyesit;

gj) çdo ndryshim, që lidhet me të dhënat e përkthyesit ose të interpretit dhe organizimin e përkthyesit;

h) të dhëna për procedimet disiplinore, vendimet e komisioneve disiplinore përkatëse, masat disiplinore;

i) të dhëna për përkthyesit dhe interpretët e çregjistruar nga regjistri elektronik i përkthyesve;

j) të dhëna për kontraktimet dhe shërbimet e ofruara;

k) të dhëna për dokumentet shoqëruese dhe informacione që regjistrohen, njoftohen apo depozitohen në regjistrin elektronik të përkthyesve;

l) të dhëna për sistemin e pikëzimit të përkthyesit zyrtar;

ll) të dhëna për trajnimet dhe kualifikimet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e përkthimit zyrtar ose të interpretimit;

m) çdo të dhënë tjetër, që i shërben ushtrimit të veprimtarisë të përkthimit zyrtar ose interpretit të gjuhës së shenjave, në përputhje me ligjin për përkthimin zyrtar dhe kontrollit të zbatimit të këtij ligji nga Ministria e Drejtësisë.

13/7. Të dhënat e regjistrit elektronik të përkthyesve që parashikohen në pikën 13/6, të këtij vendimi, shkronja “a” deri në shkronjën “gj”, të këtij vendimi, publikohen elektronikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.



13/8. Çdo përkthyes ose interpret i gjuhës së shenjave është i detyruar t'i përgjigjet menjëherë kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë për të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 13/6, të këtij vendimi, si dhe të deklarojë jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, çdo ndryshim të të dhënave që përmban regjistri elektronik i përkthyesve, sipas parashikimeve të ligjit për përkthimin zyrtar, duke paraqitur edhe dokumentin përkatës që vërteton këto ndryshime sipas rastit. Përkthyesit dhe interpretët mbajnë përgjegjësi ligjore individuale për vërtetësinë e të dhënave, që paraqesin për plotësimin apo ndryshimin e të dhënave që përmban regjistri elektronik i përkthyesve me qëllim përditësimin e tyre.

13/9. Në rast se në regjistrin elektronik të përkthyesve konstatohen pasaktësi, gabime teknike apo gabime të tjera gjatë apo pas regjistrimit të përkthyesit ose të interpretit, me kërkesë të subjektit të interesuar apo kryesisht, korrigjohen nga Ministria e Drejtësisë. Realizimi i korrigjimit dhe të dhënat e korrigjuara publikohen në regjistrin elektronik të përkthyesve, si dhe i njoftohen përkthyesit ose interpretit.

13/10. Regjistri elektronik i përkthyesve parashikon sistemin e pikëzimit, ku palët kontraktuese mund të kryejnë vlerësimin e shërbimit të dhënë nga përkthyesi zyrtar. Ky sistem përfshin, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

a) organin apo subjektin pranë të cilit përkthyesi zyrtar ka dhënë shërbimin për të cilin është kontraktuar;

b) të dhënat e shërbimit të ofruar;

c) vlerësimin e respektimit të afateve për plotësimin e detyrave;

ç) vlerësimin e disponueshmërisë së përkthyesit zyrtar;

d) vlerësimin e paanshmërisë së përkthyesit zyrtar;

dh) vlerësimin e komunikimit dhe etikës së përkthyesit zyrtar;

e) totalin e vlerësimit.

13/11. Subjektet e interesuara plotësojnë dhe dërgojnë formularin e vlerësimit me të dhënat e mësipërme, sipas modelit të aksesueshëm në regjistrin elektronik të përkthyesve dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, nëpërmjet shërbimit postar apo në rrugë elektronike pranë Ministrisë së Drejtësisë.

13/12. Mbi bazën e të dhënave që rezultojnë nga sistemi i pikëzimit të përkthyesve zyrtarë, Ministria e Drejtësisë harton të paktën një herë në vit raportin e analizës, duke evidentuar gjetjet dhe problematikat ndaj përkthyesve në ofrimin e shërbimit të përkthimit zyrtar sipas ligjit, me qëllim marrjen e masave për adresimin efektiv të tyre.

13/13. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e mëposhtme:

a) Të dhëna referenciare të gjendjes civile, si numri personal i identifikimit, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia, adresa;

b) Të dhëna referenciare si emri i subjektit, tipi i subjektit, forma ligjore, NUIS, bashkia, adresa, shteti.

13/14. Regjistri elektronik i përkthyesve ndërvepron me bazat e të dhënave, si më poshtë vijon:

a) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga institucioni përgjegjës, i përcaktuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, "Për Gjendjen civile", të ndryshuar, për të dhënat që lidhen me përbërësit e gjendjes civile të përkthyesve dhe interpretëve;

b) Regjistrin Tregtar, administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për të dhënat që lidhen me statusin dhe formën e organizimit të përkthyesve dhe interpretëve si subjekte tregtare.

13/15. Dhënës të informacionit në regjistrin elektronik të përkthyesve janë:

a) Ministria e Drejtësisë;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

c) Qendra Kombëtare e Biznesit.

13/16. Subjekte të interesuara në regjistrin elektronik të përkthyesve janë:

a) përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave, të certifikuar sipas ligjit për përkthimin zyrtar;

b) gjykata;

c) prokuroria;

ç) oficeri i policisë gjyqësore;

d) Gjykata Kushtetuese;

dh) çdo autoritet publik, të cilit ligji u ka njohur të drejtën për përkthimin zyrtar, sipas ligjit për përkthimin zyrtar.

13/17. Niveli i aksesimit në regjistrin elektronik të përkthyesve paraqitet, si më poshtë vijon:

a) Ministria e Drejtësisë ka akses të plotë dhe të pakufizuar në informacionin që prodhohet,



regjistrohet dhe administrohet në regjistrin elektronik të përkthyesve, në rolet:

- i. lexues;
- ii. auditues;
- iii. monitorues;
- iv. aprovues;
- v. prodhues i statistikave përkatëse.

b) Subjektet e interesuara, të përcaktuara në pikën 13/16, të këtij vendimi, kanë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë në leximin dhe printimin e të dhënave, që pasqyrohen në regjistrin elektronik të përkthyesve për përkthyesit dhe interpretët.

13/18. Ministria e Drejtësisë përfaqëson autoritetin e vetëm, i cili përcakton të drejtat dhe kufizimet e operimet në regjistrin elektronik të përkthyesve për të gjitha subjektet, që u jepet e drejta e aksesit në regjistrin elektronik të përkthyesve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

13/19. Veprimet në regjistrin elektronik të përkthyesve kryhen nga nëpunësit e Ministrisë së Drejtësisë, të autorizuar për këtë qëllim nga ministri i Drejtësisë. Këta nëpunës kanë të drejtë të kenë akses të drejtpërdrejtë në leximin, printimin, shkrimin dhe modifikimin e të dhënave të regjistruara në regjistrin elektronik të përkthyesve.

13/20. Aksesit në regjistrin elektronik të përkthyesve i nënshtrohet rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.”

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 658, datë 10.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 879, DATË 12.8.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR, GJIMNAZI ‘LINZ’, NË QYTETIN E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e

Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në titull dhe në pikën 1, të vendimit nr. 879, datë 12.8.2009, të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Linz” zëvendësohet me “The independent”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe institucioni arsimor privat parauniversitar, gjimnazi “The independent” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 659, datë 10.10.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 171, DATË 27.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 171, datë 27.3.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2, të nenit 4, fjalët “... sipas raportit 80%/20%...” zëvendësohen me “... sipas raportit 70%/30%...”.



2. Në nenin 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 2, fjalët “... për sa është e mundur...” hiqen;

b) Në shkronjën “dh”, të pikës 5, fjalia e tretë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në rast mungese të shërbimit me vrojtues plazhi, inspektorati përgjegjës për turizmin merr masa administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe parashikimet e kësaj rregulloreje.”.

3. Në nenin 14 bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 1, pas fjalëve “... për vitin 2022...” shtohen “... dhe për sezonin turistik 2023–2024...”;

b) Në pikën 13, pas fjalëve “... merr masat administrative...” shtohen “... në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 189, datë 4.10.2022

**PËR NJË SHITESË DHE DISA
NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 463,
DATË 10.12.2020, “PËR PËRCAKTIMIN E
INSTITUCIONEVE DHE ORGANEVE
QË MARRIN TË DHËNA PERSONALE
NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE, SI
DHE MËNYRËN, LLOJIN DHE SASINË
E INFORMACIONIT QË DUHET TË
MARRIN”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikave 2, 2/1 dhe 3 të nenit 3, të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile” i

ndryshuar, si dhe shkronjës “k”, të pikës 1, të nenit 31 dhe nenit 32, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

1. Në aneksin I, pjesë përbërëse e udhëzimit nr. 463, datë 10.12.2020, bëhet shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

2. Pas pikës 36 të aneksit I, shtohet pika 37 dhe pikat 10, 33 dhe 35, të aneksit I, ndryshohen me përmbajtjen, sipas “listës së institucioneve që marrin informacion, bazës ligjore përkatëse, llojit dhe sasisë së informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyrës së vënies në dispozicion të këtij informacioni”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR
I BRENDSHËM

Bledar Çuçi

KOMISIONERI PËR TË
DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi



ANEKS I

LISTA E INSTITUCIONEVE QË MARRIN INFORMACION, BAZA LIGJORE PËRKATËSE, LLOJI DHE SASIA E INFORMACIONIT QË JEP SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE DHE MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË KËTIJ INFORMACIONI

10	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, nenet 38, 39, 76, 78 Vendimi nr. 209, datë 6.4.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së përgjithshme, të Burgjeve”, nenet 10, 11, 12, 18, 19, 38, 49, 73	Të dhënat që lidhen me identifikimin e të dënuarit si dhe të dhënat e nevojshme për takimet, vizitat dhe lejet e veçanta si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për plotësimin e dosjes/ dokumentacionit të personit në paraburgim apo të burgosur.	Në formë shkresore, sipas kërkesës
33	Shërbimi i Provës	Ligji nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, neni 31	Të dhënat që lidhen me identifikimin e personit nën mbikëqyrje dhe të dhënat e nevojshme për plotësimin e raportit.	Në formë shkresore, sipas kërkesës
35	Zyra vendore e Përmbartimit Përmbartuesi Gjyqësor Privat/ Zyra e Përmbartimit Privat	Ligji nr. 8116 datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 516/a Ligji nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, i ndryshuar, neni 26, “Mbledhja e të dhënave” Ligji nr. 26, datë 8.5.2019, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, neni 24, “Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor”, neni 36, “Të drejtat e përmbartuesit gjyqësor privat”, neni 53 “Marrëdhëniet me të tretët”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe të vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike
37	Ministria e Drejtësisë	Vendimi nr. 149, datë 20.3.2019 i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikën të përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e informacionit të sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur”, pika 10, shkronja “b”, nënndarja “iv”	Të dhënat referenciale të gjendjes civile, si: numri personal, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia/njësia administrative, adresa.	Në formë elektronike
		Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, neni 4 Vendimi nr. 618, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, i ndryshuar	Të dhënat e identifikimit të kërkuarit, si: emri, atësia, mbiemri.	Në formë elektronike
		Ligji nr. 10 193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar, neni 29, pika 5	Të dhëna të gjendjes civile, si emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vendbanimi dhe vendqëndrimi.	Në formë elektronike
		Ligji nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, neni 10, pika 3	Të dhëna referenciale të gjendjes civile, si numri personal i identifikimit, emri, mbiemri, atësia, vendlindja, datëlindja, gjinia, bashkia, adresa.	Në formë elektronike, përmes ndërveprimit të bazave të të dhënave shtetërore përkatëse

**URDHËR****Nr. 193, datë 6.10.2022****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”; dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Brendshëm, drejtorit të Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë z. Vledar Skënderi, nga data 7.10.2022 deri më datë 11.10.2022, për këtë çështje:

- nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues për fitimin e shtetësisë shqiptare pranë Presidentit të Republikës.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Agjencisë së Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë z. Bledar Skënderi.

3. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën e sipërcituar me ndërprerje, vetëm në rastet kur kompetencat rimerren nga titullari i institucionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR**Nr. 195, datë 10.10.2022****PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, z. Besfort Lamallari, nga data 10.10.2022 deri më datë 11.10.2022.

2. Pjesëmarrjen e zëvendësministrit të Brendshëm, z. Besfort Lamallari, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit Kombëtar, datë 10.10.2022.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, z. Besfort Lamallari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

URDHËR**Nr. 298, datë 4.10.2022****PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË DREJTORIT TË PROKURIMEVE DHE PARTNERITETEVE NË MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të urdhrit të Kryeministrit nr. 165, datë 5.10.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ngarkimin e znj. Rudina Luka për ushtrimin e detyrave të drejtorit të Prokurimeve dhe Partneriteteve në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), krahas ushtrimit të detyrës aktuale të Përgjegjësit të Sektorit të Financës dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të bregdetit (AKB).

2. Znj. Luka do të ushtrojë detyrat shtesë të drejtorit të Prokurimeve dhe partneriteteve, në MTM, duke filluar nga data 4.10.2022, deri në shfuqizimin e këtij urdhri.



3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe të gjitha drejtoritë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 442, datë 6.10.2022

PËR DISA SHTESA NË URDRIN NR. 365, DATË 10.8.2022, “PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA HUNGARIA, LETONIA, UKRAINA, RUMANIA, ITALIA, GJERMANIA, LITUANIA, MOLDAVIA, SLLOVAKIA, SERBIA, ESTONIA, BULLGARIA, POLONIA DHE MAQEDONIA E VERIUT”, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës; neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 365, datë 10.8.2022, bëhen shtesat si vijon:

1. Në pikën 1 bëhen shtesat:

a) Në paragrafin e dytë “Shteti i Letonisë”, shtohet togfjalëshi:

“rajoni Latgales, qyteti Rēzekness, njësia administrative Vērēmu;”.

b) Në paragrafin e katërt “Shteti i Italisë”, shtohet togfjalëshi:

“rajoni i Sardegna, qyteti Sassari;”.

c) Në paragrafin e pestë “Shteti i Gjermanisë”, shtohet togfjalëshi:

“rajoni Brandenburg, qyteti Uckermark, njësia administrative Prenzlau;”.

ç) Në paragrafin e trembëdhjetë “Shteti i Maqedonisë së Veriut”, shtohet togfjalëshi:

“qyteti Karbinci, Kumanovo, Štip.”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 570, datë 30.9.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG), znj. Albana Tole, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

2. Kompetencat e deleguara të kryetarit të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG), do të ushtrohen deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri znj. Albana Tole, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi



URDHËR

Nr. 602, datë 6.10.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Albana Tole, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, për ngritjen e komisioneve *ad-hoc* për njohjen e titujve akademikë për secilin aplikim për njohje titulli akademik të fituar jashtë vendit, me pedagogë ekspertë të fushës përkatëse të kategorisë “Profesor”, si dhe kryesimin e tyre.

2. Kompetencat e deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohen deri në shfuqizimin e tij, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri znj. Albana Tole zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

VENDIM

Nr. 41, datë 5.10.2022

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË NR. 49, DATË 5.8.2020, “PËR MIRATIMIN E MBYLLJES SË FAZUAR TË AKTIVITETIT TË NDËRMJETËSIMIT TË INVESTIMIT TË PERSONAVE FIZIKË NË BONO THESARI NËPËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË”, DHE PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË NR. 33, DATË 6.7.2022, “PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN, ‘PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)’”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 113, pikat 1 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44, datë 30.4.2015, me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 49, datë 5.8.2020, “Për miratimin e mbylljes së fazuar të aktivitetit të ndërmjetësimit të investimit të personave fizikë në bono thesari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë”.

2. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 33, datë 6.7.2022, “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren ‘Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISAR)’”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 1, shkronjat “a”, “b”, nën-pika ii, “e”, nën-pika “i”, “g” dhe “k” shfuqizohen;

b) Pika 2 shfuqizohet.

3. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit të



Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM

Nr. 418, datë 29.9.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 122, DATË 20.10.2020, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KUKËS”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 29.9.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit Për një ndryshim në pikën 2, germa ‘a’, të vendimit të Komisionit Kombëtar nr. 122, datë 20.10.2020, Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kukës”, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kukës (UK Kukës), me shkresën nr. 332 prot., datë 13.9.2022, me lëndë “Shkresë përcjellëse” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë

dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullore së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Kukës për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Kukës, me vendimin nr. 122, datë 20.10.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kukës, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Kukës sh.a., z. Eduard Spahia, ka përfunduar studimet e larta në Inxhinierinë Hidroteknike në vitin 2019.

5. ERRU-ja bën vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kukës sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Kukës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 2, germa “a”, të vendimit të KKRR-së nr. 122, datë 20.10.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kukës” bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor: z. Eduard Spahia”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë